



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.05.2022, të parashtruar nga Operatorët ekonomik: 1. N.T.T." AGROINVEST - G " dhe 2. N.T.Sh.,Marash - Shped Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi dhe sanimi i parqeve " , Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-020-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Aprovohen si pjesërisht të bazuara** kërkesat për ri-shqyrtim të Operatorëve ekonomik: 1. N.T.T." AGROINVEST - G ", dhe 2. N.T.Sh.,Marash - Shped Sh.p.k. të dt.26.05.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: " Ndërtimi dhe sanimi i parqeve " , Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-020-521, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 18.05.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Përmirësohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 18.05.2022;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**

A r s y e t i m

Operatorët ekonomik: **1. N.T.T." AGROINVEST - G "**, dhe **2. N.T.Sh.,,Marash - Shped Sh.p.k**, kanë parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi dhe sanimi i parqeve", Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm- 632-22-020-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.05.2022, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesave për rishqyrtim të Operatorëve ekonomik: **1. N.T.T." AGROINVEST - G "**, dhe **2. N.T.Sh.,,Marash - Shped Sh.p.k**, të dt.26.05.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorëve në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëj përmirësimin e dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

z.Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

